



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 2/8 DATË 18 / 07 / 2022

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR
PROJEKTIN E INVESTIMIT “KAMPINGU PA EMËR – GURI I LËMUAR” ME
SUBJEKT APLIKUES “KAMPING PA EMËR PEPOSHI KARPEN-KAVAJË”
SH.P.K. ME NUIS K72701801L**

Në mbështetje të 8, 9, 13 dhe 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti “Kampingu pa emër – Guri Lëmuar” konsiston në ndërtimin e një agroturizmi, kamping me vila druri dhe vende për kampera e tenda, serë, shërbim tregu fruta -perime nga produkte të zonës në ZK 2909 dhe ZK 2099, në Guri Lëmuar, Spille, Bashkia Kavajë.
- Projekti synon të realizohet nga subjekti “Kamping pa emër Peposhi Karpen - Kavajë” sh.p.k. me NUIS K72701801L.

- Vlera e investimit për këtë projekt parashikohet të jetë 5,223,868 (pesë milion e dyqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 81 (tetëdhjetë e një) persona.
- Pasuritë Nr: 90/ 29, 90/38 dhe 90/28 në ZK nr. 2099, Bashkia Kavajë, janë në pronësi të subjektit aplikues. Subjekti kërkon masë mbështetëse përdorim të pasurive të paluajtshme të pretenduara shtetërore, afërisht një gjurme prej rreth 7.7 ha, pjesë të pasurisë nr. 106/22.
- Zona përkatëse e plazhit sipas koordinatave në dokumentin e sjellë nga aplikuesi, nuk rezulton të jetë përfshirë në listën e plazheve, referuar VKM-së nr. 171, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit””, i ndryshuar.
- Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Kampingu pa emër – Guri Lëmuar”, me subjekt investues “Kamping pa emër Peposhi Karpen - Kavajë” sh.p.k. me NUIS K72701801L, Guri Lëmuar, Spille, Bashkia Kavajë në procedurën e asistuar dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Projekti në fjalë nuk vlerësohet i maturuar, mungojnë të dhëna të detajuara dhe informacioni i plotë kadastral për gjurmën e synuar si masë mbështetëse dhe për më tepër nuk ilustron në projekt lidhja ndërmjet gjurmës privat dhe gjurmës shtet që kërkohet prej 7.7 ha.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVËNDËSKRYEMINISTËR

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

SOKOL NANO